



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË  
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU  
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	08.02.2021
11 NR/BR.	11/20
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	<b>Thirrje për aplikim</b>

## Thirrje për aplikim

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë-Ferizaj në bazë të vendimit nr.11/15 të datës 03.02.2021 në përkrahje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2021 do të bëjë: Furnizimin e fermerëve kultivues të grurit me pleh artificial azotik 27% N.

Sasia e tërësishme që do të subvencionohet është 220,000kg Përfitues të këtij subvencionimi do të jenë fermerët aplikues që kanë mbjellur grurë në vjeshtën e vitit 2020 dhe sipërfaqja e mbjellur duhet të jetë 2ha e më shumë.

Shpërndarja do të bëhet në mënyrë proporcionale bazuar në sipërfaqen për të cilën kanë të mbjellur dhe aplikojnë sipas Thirrjes për aplikim.

Përfitues mund të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt,
- Parcelat e mbjellura të jenë në teritorin e komunës së Ferizajt,
- Të ketë aplikuar sipas kushteve të kërkuara,
- Të ketë të mbjellur 2 ha e më shumë grurë,
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit që dëshmohet me një kontratë,
- Fermerët duhet të aplikojnë me të njëjtin emër që do të aplikojnë për subvencione nga MBPZHR.

**Vërejtje:** Në rast të deklarimit jo të saktë të sipërfaqes së mbjellur me grurë fermerët do të ndëshkohen për 3 vite me humbje të drejtës për aplikim për subvencione dhe grante nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë Ferizaj.

Fermerët e interesuar do të aplikojnë në Zyrën Pritëse- kati përdhësë- Komuna e Ferizajt.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Fletëaplikacionin e plotësuar (mirret në Zyrën Pritëse);
- Dëshminë kadastrale për pronësi (fletën poseduese) kopje- viti 2021 ;
- Kontratë për qiramarrje nëse toka është e marrë me qira (formularin për kontratë mund ta merrni në Zyrën pritëse);

Afati për aplikim fillon nga data 08.02.2021 deri më 05.03.2021.